

**Ky dokument nuk është prova.** Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

## ARTIKULLI

|         |                                                                                                                                                                                                                                                                                     |
|---------|-------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|
| TITULLI | Nga Ndriçim Kulla - Dorëheqja urgjente e Edi Ramës nuk është më vetëm një kërkesë e opozitës, por edhe e ndërkombëtarëve                                                                                                                                                            |
| ADRESA  | <a href="https://www.syri.net/op-ed/919039/doreheqja-urgjente-e-edi-rames-nuk-eshte-me-vetem-nje-kerkese-e-opozites-edhe-e-nderkombetareve/">https://www.syri.net/op-ed/919039/doreheqja-urgjente-e-edi-rames-nuk-eshte-me-vetem-nje-kerkese-e-opozites-edhe-e-nderkombetareve/</a> |
| BURIMI  | syri.net                                                                                                                                                                                                                                                                            |
| GJENDJA | edited                                                                                                                                                                                                                                                                              |

## KOHA


|                       |                                                                                                                                                           |
|-----------------------|-----------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|
| KAPUR NGA NE          | 25 shtator 2026, 07:47:11 UTC<br><i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>                            |
| DEKLARUAR NGA PORTALI | 25 shtator 2026, 07:43:39 UTC<br><i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i> |

## HASH-ET · SHA-256

|            |                                                                  |
|------------|------------------------------------------------------------------|
| PËRMBAJTJA | 8390b43a1c9ab0e4864e11ed1a8ecbd398dc31a2e92fb9a8509d5527ca7cf52f |
| TEKSTI     | a62d74b53ac5a0d8f59c1b866a02b0c705396317ab34307fd5dceabd33c5fe1d |
| PAMJA      | 5ffe3c896a66eb1f9d974c9efdec2d758136ff31d7eefabc4a731c2d6795bcfa |

## ZINXHIRI I PROVËS

|               |                                                                                                 |
|---------------|-------------------------------------------------------------------------------------------------|
| KJO HYRJE     | ac571c5e583806ff0f7969d482fb58c23be23b0f10d5ecafc1335133091ae5f7                                |
| E MËPARSHMJA  | 354de6401af19fa50248f8ee0e1fcd44c401da6ba4357904d871cf942b0fdb3d                                |
| RRËNJA MERKLE | 8b8efb9319bb60e287a9053a50eed732645594d6e8c6608cdfef651dfbc0b1533                               |
| ANKORIMI      | submitted — dërguar, ende pa bllok<br><i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i> |



## SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahase hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/ac571c5e583806ff0f7969d482fb58c23be23b0f10d5ecafc1335133091ae5f7>

## PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px



**NDRIÇIM KULLA**

Dorëheqja urgjente e Edi Ramës nuk është më vetëm një kërkesë e opozitës, por edhe e ndërkombëtarëve

**ENVER BYTYÇI**

Vendimi i Hagës dhe raportit ynë me të vërtetën!



## Dorëheqja urgjente e Edi Ramës nuk është më vetëm një kërkesë e opozitës, por edhe e ndërkombëtarëve



Nga Ndrim Kulla - 09:43, 25/09/2026

Nëse konjunkturat gjeopolitike dhe përparësitë e epokës së rënduar ku po jetojmë, me luftëra e konflikte, i kanë detyruar të kenë qenë të shurdhëta ose të kenë mbyllur një sy, përpara prioriteteve të tjera, tanimë kjo alibi ka rënë. Tanimë, skandali i cenimit të sigurisë sonë kombëtare prek njëherësh të gjithë ato organizma e institucione ku ne aderojmë ose jemi anëtarë, prek dhe cenon direkt edhe sigurinë kombëtare të vendeve të tyre. Nëse ndërkombëtarët nuk duan të dëgjojnë zërin e opozitës, që me vite e ka dokumentuar rrezikun e regjimit Rama të lidhur me krimin dhe trafikun ndërkombëtar të drogës, nëse ndërkombëtarët nuk duan të dëgjojnë as edhe popullin shqiptar, rininë e së ardhmes së tij, që tash 100 e ca ditë ka dalë në shesh, kundër tij personalisht, duke e bërë këngë e bejte për dorëheqjen, ndërkombëtarët së fundi duhet të dëgjojnë edhe shërbimet e tyre sekrete, raportet e tyre për rrezikun që u kanoset sigurisë kombëtare të vendeve të tyre, nga bandat shqiptare, të cilave u fiken radarët e shtetit shqiptar, që të vërshojnë lirisht në Europë e në botë punët e tyre të pista. Nuk ka turp a gjëmë më të madhe diskreditimi, se sa ky që ti i ke lënë, o Edi Rama, vendit tonë, në gjithë historinë e shtetit shqiptar!

Nëse Balluku e Veliaj ishin veglat e tua politike, dil e thuaj tanimë publikisht, se Agasi e Vlorë Hyseni janë veglat e tua të nëndheshme të politikës së krimit dhe grupeve kriminale. Po, po. Që të dy janë bashkëpunëtorët e tu më të afërt, madje për Vlorë Hysenin ti ke luftuar me opozitën që e ka kundërshtuar në Kuvend, dhe më e keqja, ke shpërfillur shkarkimin dhe njollosjen e saj me fakte për rrjedhje të qëllimshme informacioni sekret nga institucionet e Kosovës. Dil e përgjigju popullit e ndërkombëtarëve, pse mbaruan profesionistët shqiptarë, që ti të zgjedhësh për interes të kalenderit tënd antikombëtar, si matuf i rrjedhur që je transformuar, po të njëjtin emër që të tjerët e shkarkojnë, e të shoqëruar me lidhje dhe CV tërësisht të papërshtatshme për postin? Pse, se dije ti, o tuhaf trushpëlarë, se si këshilltarja jote e sigurisë, ajo nuk mund t'i kalonte testet e pajisjes me dy certifikatat më të

## më të lexuarat



Nga lindja në perëndim: Pse Turqia po luan në të dyja anët



Putini vë në provë shpresat e Trump-it për një marrëdhënie të re me Rusinë



A po lind pas Hagës një kauzë e re shqiptare?



Ferri pas hekurave: Burgjet e Italisë kthehen në furra



Miqësi, ndryshim kursi dhe akuza: Si e sheh Evropa Izraelin



Rritja e çmimeve, zemërimi i votuesve në Francë: Si mund ta formësojë kriza e karburantit fushatën presidenciale



Dorëheqja urgjente e Edi Ramës nuk është më vetëm një kërkesë e opozitës, por edhe e ndërkombëtarëve

ia ta të sigurisë se një shtet i shtetit ajo këtu që centralizuar? A mos varet i falsifikoi? Kush ia falsifikoi? Kush i jep asaj fuqinë të fikë radarët e një shteti? Se s'ka teveqel, si ty, që të besojë se radarët i fik një njeri i vetëm, dhe të tjerët nuk shohin, nuk dinë?

politikë e ndërkombëtare

Jo, jo, ti nuk je as tuhaf, as teveqel e as matuf, as përgjegjësia e Hysenit nuk është personale, ashtu siç po përlitet shumë në mediat e pushtetit. Po njëlloj, dua t'i shkel me këmbë edhe arsyetimet e luftës së brendshme për pushtet. E aq më keq të flas për jetën paralele të orgjive apo erotikën destruktive të pushtetit. Jo, jo, ti je i qëllimshëm në gjithçka që ke bërë, e ke zgjedhur pikërisht për këtë gjë, për këtë ves që ajo ka, të rrjedhë informacionin. Po ku vallë? Për çfarë? E ke drejtuar, e ke mbrojtur dhe ke mbyllur të gjithë sytë e veshët e shtetit, që të mos pyeste e kontrollonte se çfarë bëhej me radarët. Një vepër e tillë nuk i takon dot as SHISH e as kryetares së saj, i takon kryetarit të qeverisë, që je ti, Edi Rama, dhe presidentit tënd të zgjedhur që po e shtrëngon fort si noter. Një fuqi të tillë s'e ka askush, as Agasi, as Hyseni, e ka hosteni yt, Edi Rama, sepse ti i përdor aty të dy si guri i qoshes që je, i mafies shqiptare të trafikut ndërkombëtar. Ndaj, njerëzit po tromaksen nga çfarë po dëgjojnë, një shtet i tërë që fiket përpara krimin. E të mendosh që është vetëm pjesa romantike e ajsbergut të krimin. Po pjesa kriminale, po pjesa brutale e përdorimit të shtetit deri ku shkon?

Nuk po flas për opozitarët, se tashmë ata e dinë mirë se kush je ti, as për rininë e përditshme në shesh, se ajo t'i ka bërë vezë e domate fjalët e propagandën boshe, po flas për socialistët që e duan këtë vend. Një shtet që përdoret për drogë e punë të pista, infekton të ardhmen e fëmijëve tanë, na infekton dhe jetën tonë, na mbyt, na asfikson, na vdes. Asnjë fjalë, asnjë reagim, qoftë edhe nga një deputet i vetëm, tregon se përfaqësimi politik i Partisë Socialiste ka rënë, është i mbuluar nga turpërimi historik i shtetit, nga gjëma kombëtare e një shteti kriminal. Propaganda e nacionalizmit dhe mbrojtja e UÇK-së, në momentin më të keq, është mbuluar me hirin e rënies së shtetit shqiptar. Iu takon socialistëve të thjeshtë, që e duan këtë vend, të dalin në shesh e të mbrojnë nderin dhe dinjitetin kombëtar, të nëpërkëmbur për vite me radhë nga Edi Rama e veglat e zgjedhura prej tij.

Së fundmi, velloja e iluzionit është çarë edhe për ndërkombëtarët. Të kenë kujdes kur të takojnë tani e tutje Edi Ramën, sepse ato duar mund të fikin të gjithë radarët e të infektojnë të gjitha shtetet me drogë e trafikë. Të kenë kujdes kur flasin dhe promovojnë, se nga era e pistë e atyre trafikëve mund të infektohen fëmijët e qytetarët e vendeve të tyre. Se që sot e tutje ai nuk vetëquhet më lideri ndërkombëtar i rajonit, po lideri infektues i trafikut ndërkombëtar!

© SYRI.net

Lexo edhe

- » Nga lindja në perëndim: Pse Turqia po luan në të dyja anët
- » Miqësi, ndryshim kursi dhe akuza: Si e sheh Evropa Izraelin
- » Ferri pas hekurave: Burgjet e Italisë kthehen në furra

## Komentet

Shto koment

Emri

Shkruani komentin tuaj

Posto

### TË NGJASHME



Rritja e çmimeve, zemërimi i votuesve në Francë: Si mund ta formësojë kriza e karburantit fushatën



Jo revoltë kundër Merzit, por shumë pakënaqësi në prapaskenë



Putini vë në provë shpresat e Trump-it për një marrëdhënie të re me Rusinë



A po lind pas Hagës një kauzë e re shqiptare?

presidenciale



Studentët janë peng i ekraneve, po humbasin aftësinë për t'u shkëputur dhe për t'u përqendruar



Izraeli kishte dy detyra pas 7 tetorit. Dështoi në njërin prej tyre dhe humbi narrativën



Nga UÇK-ja te UÇD-ja: Beteja e re e Kosovës është Diplomatie

LAJME POLITIKË KRONIKË EKONOMI KOSOVA BOTË KULTURË SHKENCË SPORT JETË-STIL TRASHËGIMI MIEDIS ARKIVA



SYRI.net është agjencia më e madhe e lajmeve në Shqipëri, që brenda një kohe të shkurtër është kthyer në lider të informacionit. Në SYRI.net do të gjeni opinionistë më me emër në vendin tonë, investigime dhe lajme që nuk do ti gjeni diku tjetër. Lajmet në SYRI.net janë prodhim i SYRI.net dhe nuk lejohet marrja e tyre pa një komunikim të mëparshëm me redaksinë. Ju ftojmë të klikoni dhe të na shkruani sa herë që ju mendoni se duhet. Stafi i SYRI.net

Për informacione [info@syri.net](mailto:info@syri.net), për reklama [marketing@syri.net](mailto:marketing@syri.net)

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.